




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV Dukagjini
Ermal Panduri
Drejtör
Prishtinë



VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2021/311 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për TV Dukagjini
(Pala Përgjegjëse)**

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 28 maj 2013 ka nxjerrë Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale KPM 2013/01. Me këtë rregullore është përcaktuar mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe zgjedhjes së kohës së transmetimit të programeve të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin fizik, mental, emocional dhe moral të fëmijëve dhe të miturve.
2. KPM me datë 18 gusht 2021, mori Vendim që Pala përgjegjëse të sanksionohet me Vërejtje për shkelje të nenit 7, paragrafi 1 të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale dhe shkelje të nenit 12 paragrafi 1 nenit 14 paragrafi 4, si dhe nenit 15 të Rregullores KPM- 2017/07.
3. KPM-së ka bërë monitorimin e Palës përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me rregulloret e KPM-së: Rregulloren KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale, Rregulloren KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale si dhe Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës, lidhur me transmetimin e përmbajtjeve programore të cilat mund të jenë të dëmshme për fëmijë dhe të mitur. Monitorimi është bërë për 24 orë brenda një jave nga data 24 deri 26 tetor 2021.
4. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 27 tetor 2021, ka gjetur se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të programit për fëmijë “Kuzhina e Bebi” me datë 24 tetor 2021 ka bërë reklamim me ekran të ndarë dhe vendosje të produkteve.
5. KPM në bazë të Raportit të monitorimit ka gjetur se edhe programin mëngjesit rubrika për fëmijë “Diskutim për fëmijë” përmban vendosje të produkteve dhe shfaqen logo të sponsorëve.

6. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 27 tetor 2021 ka gjetur se Pala përgjegjëse në emisionin “Radar” të datës 25 dhe 26 tetor 2021, ka transmetuar reklamën GO+, si dhe reklama e lojës shpërblyese “U kall loja” jashtë kohës së përcaktuar me rregullore.
7. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 27 tetor 2021 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2017/07, duke i ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh të përgjigjen dhe të ofrojnë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e lartpërmendura.
8. KPM nuk ka pranuar përgjigje nga Pala përgjegjëse pas dërgimit të Njoftimit për shkelje.
9. KPM pas Njoftimit për shkelje ka bërë edhe një monitorim të dytë për të parë nëse Pala përgjegjëse ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2017/07. Monitorimi është bërë me datën 1,4 dhe 7 dhjetor 2021 dhe në bazë të Raportit të monitorimit të datës 8 dhjetor 2021 është gjetur se Pala përgjegjëse, ka vazhduar të transmetojë përmbajtje programore të cilat janë në kundërshtim me Rregulloren KPM-2017/07, duke vendosur produkte në rubrikën për fëmijë në kuadër të emisionit të mëngjesit dhe duke e sponsorizuar atë.

Analiza ligjore

10. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të Rregullores KPM-2017/07, dhe Rregullores KPM-2013/01.
11. KPM, në bazë të Raporteve të monitorimit ka konstatuar se Pala përgjegjëse gjatë transmetimit të programit për fëmijë “Kuzhina e Bebit” me datë 24 tetor 2021 ka bërë reklamim me ekran të ndarë, duke vepruar në kundërshtim me nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2017/07, i cili përcakton se:

“Reklamimi me ekran të ndarë nuk duhet të jetë i tepërt në atë mënyrë që do t’ua pamundësonte shikuesve të vazhdojnë të shikojnë përmbajtjen editoriale dhe nuk duhet të përdoret në programet e fëmijëve, të fesë, të lajmeve dhe ato të çështjeve aktuale. Dispozitat e kësaj Rregulloreje në lidhje me orarin dhe kohëzgjatjen e reklamimit televiziv dhe teleshopingut do të zbatohen për reklamimin me ekran të ndarë.”
12. KPM po ashtu në bazë të Raportit të monitorimit ka konstatuar se edhe programi i mëngjesit “Diskutim për fëmijë” përmban vendosje të produkteve dhe shfaq logo të sponsorëve, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 14, paragrafi 4, të Rregullores KPM-2017/07, i cili përcakton se:

“Shfaqja e një logoje të sponsorizimit gjatë programeve të fëmijëve edhe atyre fetare do të ndalohet”
13. KPM po ashtu ka konstatuar se Pala përgjegjëse në programin për fëmijë “Kuzhina e Bebit” dhe në “Diskutim me fëmijët” ka bërë vendosje të produkteve, duke vepruar edhe në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores KPM-2017/07.

14. KPM në bazë të Raportit të monitorimit të datës 27 tetor 2021 ka konstatuar se Pala përgjegjëse në emisionin “Radar” të datës 25 dhe 26 tetor 2021, ka transmetuar reklamën GO+, si dhe reklama e lojës shpërblyese “U kall loja” të cilat kanë përmbajtje erotike dhe si të tilla i takojnë kategorisë së tretë dhe transmetohen jashtë kohës së përcaktuar me rregullore, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 5 paragrafi 3, dhe nenin 6, paragrafi 3, të Rregullores KPM-2013/01 i cili përcakton se:

“Kategoria e tretë përfshin programet, që përmbajnë skena dhune dhe fizike, si dhe përmbajtje erotike, të cilat përsëriten relativisht shpesh. Këto përmbajtje të dëmshme programore nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 14 vjeçare. Për programet e kategorisë së tretë, prania e prindit, kujdestarit, është e domosdoshme. Transmetimi i këtyre programeve duhet të paralajmërohet dhe shoqërohet me shenjë përkatëse.”

Neni 6 paragrafi 3 i të Rregullores KPM-2013/01 përcakton se:

“Transmetimi i programeve që i takojnë kategorisë së tretë, mund të bëhet prej orës 22:00 deri në ora 06:00.”

15. KPM ka konstatuar se Pala përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje të dërguar nga KPM ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri Rregulloren KPM-2017/07. Duke u bazuar në Raportin e dytë monitorues është konstatuar se Pala përgjegjëse ka vazhduar të veprojë në kundërshtim edhe me Rregulloren KPM-2017/07, duke vendosur produkte në emisione të fëmijëve dhe duke reklamuar në ekran të ndarë.
16. Komisioni si rrethanë rënduese për Palën përgjegjëse ka konsideruar dështimin e vazhdueshëm të këtij ofruesi të shërbimeve mediale për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren KPM-2013/01, Rregulloren KPM-2017/07.
17. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka konstatuar se Pala përgjegjëse ka bërë, shkelje të nenit 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 4 dhe nenit 15 paragrafi të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, si dhe shkelje të nenit 5 paragrafi 1 dhe nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve.

Vendim


18. Pala përgjegjëse sanksionohet me gjobë në shumë prej 1,000 (njëmijë) euro në pajtim me nenin 30 paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së për shkelje të nenit 12 paragrafi 1, nenin 14 paragrafi 4 dhe nenit 15 paragrafi të Rregullores KPM-2017/07 për Komunikimet Komerciale Audiovizuale, si dhe shkelje të nenit 5 paragrafi 1 dhe nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores KPM-2013/01 për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve.
19. Obligohet Pala përgjegjëse që në afat prej dhjetë (10) ditësh të bëjë kategorizimin e filmave dhe serialeve të cilat i transmeton, t'i paralajmërojë ato para fillimit me sinjal verbal dhe akustik dhe t'i identifikojë me simbolin përkatës vizual gjatë tërë kohëzgjatjes së tyre sipas kategorizimit të programeve të përcaktuara me Rregulloren KPM-2013/01. Të mos vendosë

produkte dhe të mos bëjë reklamim në ekran të ndarë në emisione të fëmijëve, ashtu siç përcaktohet në Rregulloren KPM-2017/07.

20. Obligohet Pala përgjegjëse që, duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 5 të Rregullores KPM-2013/01, të nxjerrë Kodin Praktik në të cilin do të përcaktojnë standardet vetërregulluese për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm te fëmijët dhe të miturit, dhe këtë Kod të miratuar ta sjellin në KPM brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimi të këtij Vendimi.

E drejta për ankesë

21. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
22. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Xhevat LATIFI
Kryetar



21.12.2021

Datë